



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Malishevës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Malishevës (KMAL), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Malishevës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Komuna e Malishevës në Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV), në nenin 19 Raport për pasuritë jo financiare, nuk i ka prezantuar pasuritë e blera kapitale gjatë vitit 2021, në vlerë prej 3,970,002€.  
Po ashtu edhe pasuritë nën 1,000€ nuk ishin regjistruar në sistemin e pasurive “e-pasuria” të cilat e kapin shumën 211,610€.
- B1 Si rrjedhojë e normave jo adekuate të zhvlerësimit pasuria ishte nënvlerësuar për 129,146€, regjistrimi i pasurisë si “Investime në vijim” edhe pse ato ishin në përdorim kishte ndikuar në mbivlerësim për 101,894€, dhe nga regjistrimi i pasurisë në regjistra kontabel të Komunës të cilat nuk janë në kontroll dhe pronesi të saj kishte ndikuar në mbivlerësim për 75,796€.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Malishevës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- B2 Gjatë trajtimit të detyrimeve të papaguara kemi vërejtur se, gjashtë fatura në vlerë të përbashkët 199,707€, nuk ishin raportuar në raportet mujore të obligimeve të papaguara. Mungesa e faturave reflektohen në gjashtë raporte mujore të obligimeve. Po ashtu, shtatë fatura me vlerë të përbashkët 239,538€, nuk ishin paguar brenda afatit 30 ditor, vonesat e pagesave për këto raste janë nga 12 ditë deri në 222 ditë.
- B3 Në 19 pagesa në vlerë totale prej 517,935€, Komuna ka përdorë fondet e projekteve për qëllime tjera nga ajo për çka ishin planifikuar, pa i zbatuar procedurat dhe kriteret për transferim dhe rialokim të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Malishevës.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Malishevës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Malishevës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Malishevës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Malishevës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: procesi i realizimit të pagesave nga projektet tjera, dobësi në procedimin e pagesave, të arkëtueshmet, dobësi në regjistrimin e pasurisë jo financiare, menaxhimi i obligimeve, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Po ashtu, procesi i raportimit në komunë është përcjellë me mangësi, kjo është vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së PVF-të të cilat kishin edhe gabime tjera, të cilat janë vërejtur gjatë auditimit dhe pas sugjerimeve tona janë bërë korrigjimet e mundshme. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja dhe katër (4) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja A1 - Mos regjistrimi i pasurive jo financiare kapitale të blera gjatë vitit

<b>Gjetja</b>	<p>Rregullorja MF - nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6.1 përcakton: Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël.</p> <p>Komuna e Malishevës në PFV përkatësisht, në nenin 19 Raport për pasuritë jo financiare, nuk i ka prezantuar pasuritë të cilat janë krijuar gjatë vitit 2021 përmes realizimit të shpenzimeve kapitale në vlerë 3,970,002€. Po ashtu, edhe pasuritë nën 1,000€ nuk ishin regjistruar në sistemin e pasurive "e-pasuria" në tri vitet e fundit (2019 - 2021), të cilat ishin në vlerën origjinale të blerjeve të tyre prej 211,610€.</p> <p>Mos regjistrimi i pasurisë gjatë gjithë vitit në SIMFK dhe në sistemin e "e-pasuria", sipas Komunës ishte, për shkak të mungesës së zyrtarëve përgjegjës dhe të mos funksionimit të sistemit "e-pasuria".</p>
<b>Ndikimi</b>	Kjo ka ndikuar në nënvlerësimin e pasurive të komunës për të njëjtën vlerë duke i bërë edhe PFV-të e pa sakta.
<b>Rekomandimi A1</b>	Kryetari duhet të forcoj kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare duke siguruar që të gjitha pasuritë regjistrohen në regjistrin e pasurive duke krijuar regjistra të pasurisë të plotë dhe vlerat e tyre të jenë

të sakta.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

### **Çështja B1 - Dobësi në menaxhimin e pasurive jo financiare**

#### **Gjetja**

Rregullore MF - nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton procedurat standarde për dokumentimin, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare, mbajtjen e saktë të të dhënave mbi pasurinë jo financiare përmes mirëmbajtjes sistematike të regjistrit të pasurive jo financiare kapitale.

Me rastin e testimit të pasurive jo financiare kapitale mbi 1,000€ ne kemi identifikuar se nuk janë aplikuar normat e zhvlerësimit si në4:

- Në katër (4) raste, ishin aplikuar norma jo adekuate të zhvlerësimit, kjo ishte ndikuar në prezantimin jo të saktë të vlerës së pasurive, duke e nënvlerësuar për 129,146€;

- Në dhjetë (10) raste, pasuria ishte regjistruar në regjistrin kontabël si “Investim në vijim” dhe si rezultat i sajë, nuk ishin kalkuluar shpenzimet e zhvlerësimit dhe pse këto pasuri ishin vendosë në përdorim nga vitet 2006 deri në 2016. Kjo kishte ndikuar në prezantimin jo të saktë të vlerës së pasurive neto, duke e mbivlerësuar për 101,894€; dhe

- Në tri (3) raste, në regjistrin e pasurive kapitale komuna kishte regjistruar pasurinë e cila nuk i plotëson kushtet për tu regjistruar si pasuri e komunës. Këto pasuri ishin: për ndihmë me material ndërtimor për ndërtimin e shtëpive për familjet me gjendje të rendë sociale, për furnizim me mekanizëm bujqësor për fermerët, dhe për bashkëfinancim me Kompaninë Rajonale të Ujësjellesit Hidroregjioni Jugor për hapjen e puseve. Kjo kishte ndikuar që regjistri dhe vlera e pasurive të jetë e mbivlerësuar për 75,796€. Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së mjaftueshme të kontrolleve të brendshme ndaj menaxhimit të pasurive jo financiare dhe të mungesës së zyrtarit për menaxhimin e pasurive pothuajse gjithë vitin.

#### **Ndikimi**

Kjo ka ndikuar që vlerat neto në librat e pasurive të jetë e pasaktë dhe rrjedhimisht në pasqyrat financiare vjetore të konsiderohen të pa sakta në zërin e pasurive.

#### **Rekomandimi B1**

Kryetari duhet të forcoj kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare duke siguruar që të gjitha pasuritë e regjistruara kontrollohen nëse janë regjistruar në kategorin përkatëse, janë duke u kalkuluar normat adekuate të zhvlerësimit dhe regjistri i pasurisë të jetë i plotë dhe i saktë.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja B2 - Dobesi në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve dhe kostot e procedurave përmbartimore

#### Gjetja

Rregulla Financiare nr. 02/2013 - MF - për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore, neni 5 parasheh që, të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që në Ministrinë e Financave - Thesar të raportojnë obligimet e tyre të papaguara në baza mujore. Ligji nr. 03/L-048 për MFPP, nenin 39.1, përcakton që ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe e pranuar të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Me rastin e vlerësimit të raportimeve mujore për obligimet e papaguara të raportuara në MFPT, ne kemi vërejtur se gjashtë (6) fatura me vlerë të përbashkët 199,707€, nuk ishin përfshirë në raportet mujore të obligimeve të papaguara. Prandaj, raportimi i obligimeve të papaguara ishte jo i plotë dhe i saktë.

Me rastin e testimit të faturave të pranuar për pagesat brenda afatit të përcaktuar kohor prej 30 ditëve, kemi vërejtur shtatë (7) fatura në vlerë të përbashkët 239,538€, ishin me vonesa në pagesë nga 12 ditë deri në 222 ditë.

Po ashtu, Thesari sipas vendimeve gjyqësore/përmbartimore kishte ekzekutuar pagesa nga buxheti i komunës në vlerë prej 1,298,474€. Komuna nuk ishte në gjendje të na ofroje se sa ishin shpenzimet për kryegjënë-borxhin kryesor, sa për interes dhe sa për tarifën e përmbartuesve.

Mos prezantimi i plotë i raporteve mujore të obligimeve, është rjedhojë e mos funksionimit të sistemit të kontrolleve të brendshme, ndërsa mos pagesa e detyrimeve brenda afatit kohor ishte për shkak të planifikimit jo të mirë buxhetor, të alokimit dhe zotimit të mjeteve jo me kohë.

#### Ndikimi

Mos prezantimi i raporteve të plota për obligime e papaguara, dhe vonesat në kryerjen e pagesave, mund të ndikojn që komuna të paguaj shpenzime shtesë gjyqësore/përmbartimore si rezultat i padive të ngritura nga operatorët ekonomikë.

#### Rekomandimi B2

Kryetari duhet të forcoj kontrollet e brendshme duke e rrit mbikëqyrjen dhe verifikimin e rregullt të raporteve të obligimeve të papaguara, njeherit duhet të siguroj që të gjitha faturat paguhet brenda afatit ligjor.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

**Çështja B3 - Ekzekutimi i pagesave për projekte të caktuara nga buxheti i projekteve tjera****Gjetja**

Ligji nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2021, neni 17 pika 10, tregon se, ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese apo zëvendësimin e projekteve kapitale të komunave, duhet të miratohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal.

Ministri mundet, nëse i ofrohen arsytetime të vlefshme nga ana e kryesuesit të organizatës buxhetore, të autorizojë lëvizjen e mjeteve të alokuara nga një projekt kapital në tjetrin brenda nën-programit të njëjtë të asaj organizate buxhetore. Rialokimet duhet të kryhen në përputhje me procedurat dhe kriteret e parapara me udhëzimin administrativ MF nr. 05/2019 për procedurat e transferit dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore.

Në 19 pagesa në vlerë të përbashkët 517,935€, kemi identifikuar se Komuna ka përdorë fondet e projekteve për qëllime tjera nga ajo për çka ishin planifikuar, pa i zbatuar procedurat dhe kriteret për transferim dhe rialokim të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër. Këto projekte ishin për: Asfaltimin e rrugëve lokale, ndërtimin e kanalizimeve, ndërtimin e ujësjellësëve, ndërtimin e rrugëve me kubëza, ndërtimin e ndriçimit publik, dhe për ndërtimin e infrastrukturës për gjatë lumit Mirusha-segmenti nga ura në qendër deri të transiti.

Kjo kishte ndodhur për shkak të hyrjeve në kontrata publike pa mjete të mjaftueshme për projekte të caktuara dhe shpenzimi i fondeve në projektet e caktuara me rastin e ekzekutimit të pagesave përmes vendimeve gjyqësore.

**Ndikimi**

Kjo ndikon në prezantime të gabuara të raporteve të progresit fizik dhe financiar të projekteve kapitale dhe rrezikon që buxhetimet e viteve vijuese të bëhen të pa sakta, po ashtu rritë mundësitë e vonesave për pagesa të faturave tjera.

**Rekomandimi B3**

Kryetari duhet të sigurojë që gjatë ekzekutimit të pagesave për investime kapitale për të gjitha rastet, të respektohen shumat dhe kodet e projektit përkatës siç janë të miratuara në ligjin e ndarjeve buxhetore, dhe nëse paraqitet nevoja për ndryshimin e shumave apo të projekteve atëherë të kërkohet miratimi paraprak i Kuvendit Komunal.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

#### Çështja A2 - Keq klasifikimi i shpenzimeve

**Gjetja** Sipas nenit 18, pika 3 e rregullores 01/2013 -MF për Shpenzimin e Parasë Publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Si rezultat i mos pagesës së obligimeve financiare me kohë, nga dy mostrat e testuara, pagesat e realizuara me vendime gjyqësore /përmbarimore në vlerë prej 33,250€, ishin keqklasifikuar. Pagesat ishin bërë nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime, derisa natyra e shpenzimeve ishte për investime kapitale.

Po ashtu, vlera në total prej 40,043€ është paguar nga kategoria mallra dhe shërbime që për nga natyra i takojnë kategorisë së subvencioneve. Këto pagesa ishin për shpenzime të varrimit, furnizim me pako ushqimore për familjet nevojtare, si dhe për organizatën komunale të pensionistëve dhe invalidëve të punës.

Ndërsa, një pagesë për furnizim me mekanizëm bujqësor me vlerë prej 15,000€, të cilat u ishin dhënë bujqëve në formë të subvencionimit, ishte bërë nga kategoria investime kapitale, përderisa ky shpenzim për nga natyra i takon kategorisë subvencione dhe transfere.

Keqklasifikimet e shpenzimeve kanë ndodh si pasojë e vendimeve gjyqësore, për shkak të mos pagesës së obligimeve me kohë ndaj operatorëve ekonomik, si dhe në mungesës të mjeteve financiare në kategorinë e subvencioneve dhe të keq orientimit të projekteve kodet buxhetore në ligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin 2021.

**Ndikimi** Pagesat e bëra nga kategoria ekonomike jo-adekuate, ndikojnë në keq klasifikimin e shpenzimeve në PFV-të e Komunës dhe si të tilla japin informata jo të sakta për shfrytëzuesit e PFV-ve. Në anën tjetër, pagesat përmes vendimeve gjyqësore, ndikojnë direkt në rritjen e kostos për komunën të shkaktuara nga shpenzimet shtesë.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të sigurojë që planifikimi buxhetor i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive adekuate si dhe pagesat të regjistrohen në kode përkatëse ekonomike në përputhje me planin kontabël të aprovuar nga Thesari.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

**Çështja A3 - Korrigjimi i Pasqyrave Financiare Vjetore****Gjetja**

Përgatitja e PFV-ve duhet të bazohet sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme si dhe sipas Rregullores së MFTP nr. 01/2017 për Raportimin vjetor financiar të organizatës buxhetore.

Komuna ka përgatitur dhe dërguar në Thesar PFV-të sipas afatit të paraparë deri më 30 janar. Megjithatë, me rastin e rishikimit të PFV-ve, nga ana e auditimit, janë vërejtur disa çështje të cilat i janë rekomanduar Komunës për korrigjim.

Çështjet të cilat janë identifikuar ishin:

- Te neni 13 - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme - burimet e fondeve- pranimet, janë prezantuar nga pranimet tjera në shumë prej 22,000€ sipas SIMFK-se, shuma është dashtë të prezantohet si burim i financimit nga huamarrja;
  - Te neni 14 Raporti i ekzekutimit të buxhetit - tek pjesa hyrja e parasë së gatshme, te shtylla realizimi - shënimi 12 të hyrat tjera, të hyrat nga viti i kaluar nuk janë prezantuar në vlerë prej 4,000€, sipas SIMFK-së është dashtë të prezantohen;
  - Te neni 14 Raporti i ekzekutimit të buxhetit - tek pjesa e daljes së parasë së gateshe, të shtylla buxheti fillestar - shënimi 6 Investimet Kapitale, buxheti fillestar është prezantuar 4,153,031€ (duke e bërë bashkë Kapitalet me Rezervat). Sipas SIMFK-së, investimet kapitalet janë 1,173,441€, ndërsa Rezerva duhej të shënohet ndaras në kolonën dhe shënimin nr. 7 në 2,979,590€;
  - Po ashtu te shënimi 5 Subvencione dhe Transferet - Buxheti final është prezantuar 400,000€, ndërsa sipas SIMFK-së është 459,000€.
- Pas identifikimit të gabimeve dhe këshillave nga auditimi, menaxhmenti i komunës kishte ndërmarrë veprime dhe kishte bërë korrigjimet e nevojshme dhe versioni i korrigjuar i PFV-ve ishte përgatitur dhe dorëzuar me kohë në Thesar.

Pas sugjerimeve gjatë auditimit janë bërë korrigjimet e mundshme.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të brendshme jo adekuate dhe kujdesit të mangët të stafit përgjegjës në përgatitjen e PFV-ve.

**Ndikimi**

Mos prezantimi i saktë dhe i plotë i informatave financiare dhe jo financiare në PFV, nuk paraqet një pamje të vërtetë dhe të saktë të dhënave dhe ulë shkallën e besueshmërisë tek përdoruesit e synuar.

**Rekomandimi A3**

Kryetari duhet të shtoj kontrollet gjatë hartimit të PFV-ve, në mënyrë që PFV-të për vitin 2022 të mos përmbajnë gabime kontabël dhe administrative. Deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar duhet të nënshkruhet vetëm pasi që janë siguruar se PFV-të prezantojnë të dhëna të plota dhe të sakta.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë ishte 1,996,424€, prej tyre ishin shpenzuar 1,939,499€ apo 97%. Shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve kryesisht kanë të bëjnë me: shpenzimet e derivateve dhe lëndët tjera për ngrohje, mirëmbajtje të objekteve, shpenzime kontraktuese tjera, mirëmbajtje e rrugëve, mirëmbajtje e shkollave, mirëmbajtje të TI-së, karburante për vetura, shpenzime me vendime të gjykatave, etj.

#### Çështja A4 - Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit

- Gjetja** Ligji nr. 07/L-041 mbi ndarjen buxhetore për buxhetin e republikës së Kosovës neni 13 pika 6, shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të shtesave apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat, duke përjashtuar rimbursimin apo shpenzimet e lejuara për udhëtime jashtë vendit, sipas legjislacionit përkatës.
- Komuna e Malishevës kishte organizuar shëtitje jashtë vendit për stafin e saj, konkretisht në Shqipëri me kohëzgjatje prej katër ditë duke ua paguar shpenzimet e transportit dhe akomodimit për këtë aktivitet në shumë 4,730€, ku qëllimi i këtij udhëtimi ishte për çështje rekreacioni për punonjësit e komunës.
- Sipas Komunës, kjo kishte ndodhë për shkak të mungesës së njohurive të zyrtarëve për mos lejimin e shpenzimeve të parasë publike për këtë qëllim.
- Ndikimi** Përdorimi i fondeve për qëllime tjera përveç që është në kundërshtim me ligjin e buxhetit ndikon në keq menaxhimin e parasë publike.
- Rekomandimi A4** Kryetari duhet të sigurojë se çdo shpenzim i bërë nga buxheti i komunës të bëhet për aktivitete të Komunës dhe interes publik si dhe të jetë në përputhje me ligjin mbi ndarjet buxhetore të vitit përkatës.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,113,996€, prej tyre ishin shpenzuar 3,970,002€, apo 96.5% Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e kanalizimeve, ndërtimi i rrugëve lokale, ujësjellësve, objekte arsimore, objekte kulturore, mirëmbajtje investive, pajisje mjekësore, pagesa me vendime gjyqësore, etj.

#### Çështja A5 - Pranimi i faturës para zotimit të mjeteve financiare

**Gjetja** Sipas rregullës Financiare nr. 01/2013/MF - shpenzimi i parasë publike, neni 22, hapat për procedim të pagesave janë: kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procedohet urdhër blerja, raporti i pranimit të mallit apo shërbimit, pastaj behet pranimi i faturës, tutje certifikohet/ekzekutohet pagesa në fjalë.

Nga testimi i pagesave të punëve të kryera të projekteve kapitale, kemi hasur në dhjetë (10) raste të pagesave në vlerë 340,768€ që janë realizuar pa u zbatuar procedurat e duhura. Pra janë pranuar mallra, shërbime dhe faturat para së të behet zotimi i mjeteve.

Rastet kishin të bënin për:

- Asfaltimin e rrugëve në fshatrat e Malishevës;
- Rikonstruimin dhe mbindërtimin e objektit të shkollës fillore në fshatin Marali;
- Riparimin e kanalizimeve fekale nëpër fshatrat e Malishevës;
- Ndërtimin e sistemit të ujësjellësit në fshatin Astrazup;
- Ndërtimin e ndriçimit publik në fshatrat dhe qytezën e Malishevës; dhe

Ndërtimin e infrastrukturës përgjatë lumit Mirusha-segmenti nga ura në qendër deri të tranziti.

Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e mos efektivitetit të kontrolleve të brendshme gjatë procesimit të lëndëve për pagesë nga zyrtarët financiarë.

**Ndikimi** Pranimi i faturave para zotimit të mjeteve financiare, përveç së nuk është në pajtim me kërkesat e rregullës financiare, mund të ndikoj që të pranohen punë të kryera me shumë sesa ka mjete buxhetore, rrjedhimisht mund të krijohen vështirësi dhe vonesa për pagesë.

**Rekomandimi A5** Kryetari duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë së ngjarjeve dhe në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.3.4 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV kishte prezantuar Llogari të Arkëtueshme (LI.A) në vlerë prej 3,071,534€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 1,968,316€, nga taksa komunale 934,695€ dhe nga qiraja e papaguar 168,523€. Në raport me vitin 2020, llogaritë e arkëtueshme në vitin 2021 janë rritur për 424,835€ apo 16%.

### Çështja B4 - Dobësitë në menaxhimin e Llogarive të Arkëtueshme

- Gjetja** Sipas nenin 26 të ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10€) dhe neni 27 nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.
- Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e llogarive të arkëtueshme. Siç shifet edhe më lartë, vlera e LI.A të pa inkasuara për tatimin në pronë, taksat në biznes dhe qiraja, mbesin ende me vlera të larta.
- Komuna nuk kishte ndërmarr veprime konkrete për mbledhjen e këtyre borxheve, megjithëse, kjo situatë është ngritur si çështje dhe vitin e kaluar Sipas komunës gjendja ekonomike e sociale e qytetarëve të komunës, ka sjell, deri të mos pagesa e borxheve tek tatimi në pronë, ndërsa për taksat në biznese aty ka shumë biznese joaktive.
- Ndikimi** Mos arkëtimi i të arkëtueshmeve për vite me radhë, ndikon që ato të bëhen të pa mbledhshme dhe gjithashtu rezulton me të hyra vetjake më të ulëta për komunën.
- Rekomandimi B4** Kryetari duhet të sigurojë se mbledhja e LI.A nga tatimi në pronë bëhet sipas kërkesave dhe mënyrave të përcaktuara ligjore. Ndërsa për LI.A nga taksa në biznes dhe të qirave, të shqyrtohen të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore dhe deri përmes mjeteve juridike me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave të mëposhtme:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>8</sup>	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>14,900,757</b>	<b>15,851,400</b>	<b>15,649,843</b>	<b>15,757,281</b>	<b>13,051,960</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	14,093,449	15,007,386	14,837,535	14,750,075	12,144,445
Financimi përmes huamarrjes	0	35,565	22,824	76,650	46,187
Të bartura nga viti i kaluar	0	0	0	263,417	122,519
Të hyrat vetanake	807,308	807,308	789,484	667,139	738,809
Donacionet vendore	0	508	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	632	0	0	0

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 950,643€. Rritja ishte nga: granti qeveritar në vlerë prej 913,938€, financim nga huamarrja në vlerë 35,565€ dhe grantet e donatorve në vlerë 1,140€. Kjo rritje ishte si rezultat i lejimit të shtesave në paga për: stafin shëndetësor, në shërbime esenciale dhe të zjarrfikësve dhe për kompensime të punëtorëve të arsimit përmes vendimeve gjyqësore për përmbushjen e kontratave kolektive sektoriale.

Në vitin 2021 Malisheva ka shpenzuar 98.73% të buxhetit përfundimtar, me një përmirësim rreth 2% në krahasim me vitin 2020. Realizimi i buxhetit ishte në nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.




**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>14,900,757</b>	<b>15,851,400</b>	<b>15,649,843</b>	<b>15,757,281</b>	<b>13,051,960</b>
Pagat dhe mëditjet	8,363,200	9,281,978	9,281,513	8,493,329	8,144,751
Mallrat dhe shërbimet	1,529,526	1,541,425	1,491,514	2,182,376	1,253,413
Komunalitë	455,000	455,000	447,985	454,914	304,405
Subvencionet dhe transferet	400,000	459,000	458,829	270,252	104,650
Investimet Kapitale	1,173,441	4,113,996	3,970,002	4,356,410	3,244,741
Rezervat	2,979,590	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë si më poshtë:

- Kategoria e pagave dhe mëditjeve në buxhetin final kishte rritje për 918,778€ apo 11% krahasuar me buxhetin fillestar dhe një realizim prej 9,281,513 apo 99.99%. Kjo rritje ishte nga granti qeveritar në vlerë 895,938€, financim nga huamarrja në vlerë 22,823€ dhe donacionet në vlerë 16€. Rritja ishte për shkak të shtesave në paga për stafin shëndetësor dhe të zjarrfikësve dhe të kompensimeve të punëtorëve të arsimit përmes vendimeve gjyqësore për përmbushjen e kontratave kolektive sektoriale.
- Kategoria mallra dhe shërbime kishte rritje të buxhetit për 11,899€, rritja ishte nga financimi nga huamarrja në vlerë 12,741€, nga donacionet në vlerë 158€ dhe shkurtimi nga granti qeveritar për 1,000€. Deri në fund të vitit, buxheti ishte realizuar në vlerë 1,491,514€ apo rreth 97%.
- Kategoria e komunalive nuk kishte ndonjë ndryshim të buxhetit, ndërsa buxheti i realizuar ishte 447,985€ apo rreth 98%.
- Kategoria subvencioneve dhe transfereve, kishte rritje të buxhetit për 59,000€ dhe ishte realizuar në vlerë 458,829€ rreth 100%. Rritja e buxhetit në vlerë 59,000€ ishte nga granti qeveritar dhe ishte destinuar për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut dhe vërshimet.
- Kategoria investime kapitale, kishte rritje të buxhetit për 2,940,555€ të cilat fillimisht ishin buxhetuar si rezerva dhe pastaj ishin rregulluar duke i buxhetuar për projekte kapitale në vlerë 2,979,590€, dhe zvogëlimit për 39,035€ për shkak të largimit të projektit "rregullimi i trotuarit për gjatë parkut të qytetit në Malishevë". Në fund të vitit buxheti ishte realizuar në vlerë 3,970,002€ apo 96.5%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara në vitin 2021 ishin në vlerë 911,454€ apo rreth 113% nga planifikimi. Ato kanë të bëjnë me: të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga taksa për lejet e ndërtimit, taksat për certifikata të ndryshme, të hyrat nga regjistrimi automjeteve, të hyrat nga ndërrimi i destinimit të tokës, taks për regjistrim të trashëgimisë, të hyrat nga participimet (shëndetësi, arsim), të hyrat tjera administrative, etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>807,308</b>	<b>807,308</b>	<b>911,454</b>	<b>597,329</b>	<b>735,245</b>
Të hyrat tatimore	436,484	436,484	374,471	271,768	293,319
Të hyrat jo tatimore	370,824	370,824	533,004	325,561	441,925
Të hyrat tjera	0	0	3,980		

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të Komunës së Malishevës ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna, edhe pse ky raport nuk ishte diskutuar në asamblen komunale.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, katër (4) rekomandime janë zbatuar dhe pesë (5) nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj se janë marrë veprimet e nevojshme që projektet e aprovuara të realizohen sipas planifikimit. Nëse paraqitet nevoja për ridestininim të fondeve të projekteve, kjo të realizohet nëpërmjet justifikimit dhe aprovimit paraprak nga kuvendi komunal bazuar në rregullat përkatëse.	Situata është e njëjtë si në vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbushin detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit.	Nga procedurat e testuara nuk kemi hasur në ndonjë parregullsi të tillë.	I zbatuar

3.	Investimet kapitale	Kryetari, të sigurohet përmes menaxherit të prokurimit se janë duke u aplikuar procedurat adekuate të prokurimit me qëllim të marrjes së vlerës më të mirë për paranë e shpenzuar. Po ashtu, njësitë kërkuese duhet të bëjnë analiza reale të nevojave, përfshirë edhe analizimin e kontratave paraprake gjatë procesit të peshimit që do t'u mundësonte parashikimin e sasive që do të furnizohen.	Nuk janë identifikuar çështje të tilla këtë vit.	I zbatuar
4.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit që të gjitha procedurat e prokurimit që kanë të bëjnë me punë të mos iniciohen pa u siguruar se ekziston edhe projekti ekzekutiv. Parapërgatitjet e duhura për një projekt nga njësia kërkuese do të kenë efekt direkt në hartimin e specifikimeve të qarta, duke eliminuar pengesat si të vonesave ashtu edhe të kostove shtesë.	Gjatë testimeve të bëra këtë vit nuk identifikuam ndonjë çështje të tillë.	I zbatuar
5.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurohet që njësitë kërkuese bëjnë hartimin e specifikimeve teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit po ashtu të siguroj se zyra e prokurimit forcon kontrollet e tyre duke mos lejuar që dosja e tenderit të publikohet me pozicione jo të qarta.	Gjatë testimeve të bëra këtë vit nuk identifikuam ndonjë çështje të tillë.	I zbatuar
6.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurohet se të gjitha pasuritë regjistrohen në regjistrin e pasurisë në mënyrë që të ulet rreziku i keqpërdorimit apo humbjes së pasurisë. Po ashtu, sistemi e-pasuria duhet të përdoret për evidentimin e pasurive nën 1000€.	Situata është e njëjtë si në vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurohet se bëhet krahasimi i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë si dhe azhurnohen regjistrat e pasurisë sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit. Kryetari duhet të analizoj nëse është e nevojshme hartimi i procedurave dhe rregulloreve të brendshme për menaxhimin e pasurisë së komunës.	Situata është e njëjtë si në vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj se mbledhja e llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë bëhet sipas kërkesave ligjore. Ndërsa për llogaritë e arkëtueshme nga taksa në biznes të shqyrtohen të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve.	Situata është e njëjtë si në vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimin

9.	Obligimet e papaguara	Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat dhe detyrimet financiare paguhen brenda afatit ligjor dhe punët apo furnizimet të bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.	Situata është e njëjtë si në vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatim
----	-----------------------	--	--	-----------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Enver Boqolli, Udhëheqës i ekipit



Aurora Morina, Anëtare e ekipit



Agim Sogojeva, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
<p>Komuna e Malishevës në PFV përkatësisht, në nenin 19 Raport për pasuritë jo financiare, nuk i ka prezantuar pasuritë të cilat janë krijuar gjatë vitit 2021 përmes realizimit të shpenzimeve kapitale në vlerë 3,970,002€.</p> <p>Po ashtu, edhe pasuritë nën 1,000€ nuk ishin regjistruar në sistemin e pasurive "e-pasuria" në tri vitet e fundit (2019 - 2021), të cilat ishin në vlerën origjinale të blerjeve të tyre prej 211,610€.</p>	<p>Sqarimet e Komunës së Malishevës për raportin e auditimit përkatësisht për çështjen e ngritur tek baza për opinion të kualifikuar, çështja A1, për të cilën nuk është pajtuar, është si vijon:</p> <p>Gjatë vitit 2021 i cili ishte edhe një vit me sfidën e pandemisë Covid-19, ne si Komunë e Malishevës bazuar edhe në vendimet e Qeverisë së Kosovës, kemi vazhduar punën konform masave anti-covid, me staf të reduktuar esencial. Po ashtu, në lidhje me këtë Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr.01/07 i datës: 18/04/2021 për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19, pika nën "C" [Mbrojtja dhe Siguria në Punë] nr. 7 thotë: " Të gjitha punëtoret shtatzëna duhet të lirohen nga obligimi për t'u paraqitur në punë, duke iu krijuar mundësinë që të punojnë nga shtëpia"</p> <p>Komuna e Malishevës pothuajse gjatë tërë vitit 2021 ka pasur zyrtaren e Pasurisë të paangazhuar për shkak të gjendjes së saj shëndetësore (shtatzëne) dhe nisur nga këto shkaqe objektive, në regjistrat e pasurisë nuk kemi mundur të përcjellim regjistrimet e nevojshme të pasurisë jo financiare nga Investimet Kapitale brenda OB. Ne si Komunë kemi angazhuar edhe staf shtesë (pa</p>	<p>Komuna, ka dhënë sqarime dhe treguar rrethanat që kanë ndikuar gjendjen e konstatuar nga auditimi. Megjithatë, nuk ka ofruar dëshmi apo prove tjetër që e dëshmon një gjendje ndryshe nga ajo e konstatuar nga auditimi. Andaj gjetja dhe rekomandimi te baza për opinion mbesin të njëjta.</p>

kontratë të përhershme), për të kryer punët rreth futjes së informatave të nevojshme në sistemin e Free Balance për pasuritë jo financiare të komunës mirëpo edhe sot e kësaj dite nuk i është dhënë qasja nga Ministria e Financave, për të regjistruar shpenzimet në sistemin në fjalë.

Ne si Komunë kemi mbajtur një evidence të veçantë në programin Excel të pasurive jo financiare të blera gjatë vitit 2021 si dhe një regjistër tjetër për të pasqyruar blerjet nga kapitalet por që duhet të mos figurojnë si pasuri e Komunës.





Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo



PRANUAR MË: 24/05/2022  
ACCEPTED ON:  
PRIMILJENË:  
Nr.No.Br: 01/801



Komuna e Malishevës  
Municipality of Malisheva

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Malishevës , për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Nuk pajtohem me Bazën për Opinion të Kualifikuar, pika A1, për me tepër shih të bashkangjitur komentet tona, ndërsa me gjetjet tjera pajtohem dhe nuk kemi ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.



Data: 24 maj 2022

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>9</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>10</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> · “Ndërtesat e banimit” në vlerë 23,907€ ishte furnizim me material ndërtimor për ndihme për ndërtimin e shtëpive të banimit për familjen me gjendje të rënde sociale, dhe “Furnizim me mekanizëm bujqësor për nevojat e fermerëve”, nuk i plotësojnë kushtet për tu regjistruar si pasuri e komunës. · “Hapja e puseve Piezometer (bashkëfinancim i komunës me KRU Hidroregionin 49% me 51%)”. Kjo sipas marrëveshjes për bashkëfinancim duhet të jetë pronë e Ujësjiellit dhe jo edhe e komunës. · “Shkolla fillore në Malishevë”, kishte filluar të zhvlerësohet pas 6 viteve të fillimit të përdorimit të saj, duke e nënvlerësuar për 6 vite të jetës së përdorimit. · “Ndërtimi i aneksit të shkollës fillore në Banjë” ishte regjistruar me statutin “Investim në vijim”. Si pasojë nuk ishte zhvlerësuar për 5 vite. · “Asfaltimi i rrugëve në fshatrat e Malishevës”, ishte regjistruar si “Mobile” duke i kalkuluar zhvlerësim për jetëgjatësi për 6 vite e jo për 20 vite siç do të duhej. · “Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatrat e Malishevës” ishte regjistruar me statutin “Investim në vijim”. Si pasojë nuk ishte zhvlerësuar për 6 vite. · “Kamshtëpizë Varrezat e Dëshmoreve” e regjistruar me statutin “Investim në vijim”. Si pasojë nuk ishte zhvlerësuar për 15 vite. · “Furnizim me inventar për sh.f dhe të mesme” ishte regjistruar me statutin “Investim në vijim”. Si pasojë nuk ishte zhvlerësuar për 6 vite. · “Furnizim me inventar (mobilje)” ishte regjistruar me statutin “Investim në vijim”. Si pasojë nuk ishte zhvlerësuar për 5 vite. · “Furnizim me mobilje (inventar për shkolla)” ishte regjistruar me statutin “Investim në vijim”. Si pasojë nuk ishte zhvlerësuar për 5 vite. · “Mirëmbajtja e rrugëve lokale” ishte regjistruar me statutin “Investim në vijim”. Si pasojë nuk ishte zhvlerësuar për 5 vite. · “Punimi në fushën sportive sh.f Senik-Llapqevë” ishte regjistruar me statutin “Investim në vijim”. Si pasojë nuk ishte zhvlerësuar për 5 vite. · “Rregullimi i oborrit të kopshtit të fëmijëve” ishte regjistruar me statutin “Investim në vijim”. Si pasojë nuk ishte zhvlerësuar për 5 vite. · “Renovimi i sh.f. Mirushë” ishte regjistruar me statutin “Investim në vijim”. Si pasojë nuk ishte zhvlerësuar për 5 vite. · “Asfaltimi i rrugëve nëpër fshatrat e Malishevës” ishte regjistruar me statutin “Investim në vijim”. Si pasojë nuk ishte zhvlerësuar për 5 vite.
- <sup>5</sup> · Fatura e pranuar me 04.11.2020 në vlerë 8,185€, ishte paguar me 14.07.2021; · Fatura e pranuar me 19.11.2020 në vlerë 61,530€, ishte paguar (njëra pjesë e saj) 37,136€ me 15.07.2021; · Fatura e pranuar me 08.12.2020 në vlerë 34,178€, ishte paguar me 13.07.2021; · Fatura e pranuar me 02.12.2020 në vlerë 57,856€, ishte paguar (njëra pjesë e saj) 19,670€ me 15.07.2021; · Fatura e pranuar me 02.12.2020 në vlerë 38,186€, ishte paguar me 03.08.2021; · Fatura e pranuar me 29.04.2021 në vlerë, 20,564€, ishte paguar me 12.07.2021; dhe · Fatura e pranuar me 27.05.2021 në vlerë 81,619€, ishte paguar me 08.07.2021.
- <sup>6</sup> · Asfaltimi i rrugëve në fshatrat e Malishevës dy pjesë, Loto 2, asfaltimi i rrugëve në fshatrat Carrallukë, Turjakë dhe Burim, Fatura për situacionin e dytë me vlerë 90,063€ ishte paguar me dy urdhërpagesa dhe secila me kod tjetër të projektit (nga kodi 51267 për 30,036€ dhe nga kodi 51262 për 60,000€). · Asfaltimi i rrugëve në fshatrat e Malishevës dy pjesë, Loto 2 Drenoc-Astrazup”. Fatura për situacionin e tretë me 78,784€ ishte paguar me dy urdhërpagesa dhe secila me kod tjetër të projektit (njëra nga kodi 51264 për 51,000€ dhe tjetra nga kodi 51259 për 27,784€). Për të njëjtin projekt kishte paguar situacioni i katërt me 43,245€ nga kodi 51268. · “Asfaltimi i rrugëve në fshatrat e Malishevës dy pjesë Loto 1: Terpezë, Lladrovc dhe Banjë, Loto 2 Drenoc dhe Astrazup”. Për situacionin e dytë ishte pranuar fatura e me vlerë 72,270€. Kjo faturë ishte paguar me dy urdhërpagesa të ndara dhe nga dy kode të ndryshme të projektit (njëra nga kodi 51263 për 21,962€ dhe tjetra nga kodi 51270 për 50,308€). · “Ndërtimi i ujësjiellit në fshatin Astrazup”, pagesa e fundit për 10% të kontratës nuk ishte paguar nga kodi i vet i projektit, por nga kodi 51275 në 20,781€. · “Asfaltimi i rrugëve nëpër fshatrat: Bellanicë, Ngucat, Senik, Temeqinë”. Situacioni i parë ishte paguar nga kodi i projektit 51260 shuma 43,096€, ndërsa situacioni i dytë ishte 58,773€ i paguar nga katër urdhër blerje të ndryshme: nga kodi 51264 në 19,000€, nga kodi 51262 në 18,000€, nga kodi 51265 në 11,796€, dhe nga kodi 51261 në 9,977€. · “Ndërtimi i rrugës me kabëza në fshatin Dragobil (varrezat e maturanëve drejtimi të F.SH Dragobil) dhe rruga Imer Krasniqi në Malishevë”, Situacioni i parë ishte paguar nga kodi 51256 në 44,178€, ndërsa situacioni i dytë ishte paguar nga kodi 51252 në 15,628€. · “Ndërtimi i kanalizimeve nëpër fshatrat e komunës së Malishevës, Loto 2: Cerrallukë, Vermicë, Drenoc, Llazicë, Mleqan, Bubavec, Balincë, Kijevë, Pllloqicë, Stapanicë”, Situacioni i tretë ishte paguar nga kodi 51239 për 11,485€, ndërsa pagesa e fundit për 10% ishte paguar nga kodi 51242 në 14,690€. · “Ndërtimi i kanalizimeve nëpër fshatrat e komunës së Malishevës, Loto 1: Banjë, Bellanicë, Senik, Temeqinë, Ngucat, Bardhë, Lladroc, Terpezë, Sharashnik dhe Fshat i ri”, Situacioni i dytë ishte paguar nga kodi 51240 për 15,131€, ndërsa pagesa e situacionit të tretë ishte paguar nga kodi i 51242 në 9,838€.

- <sup>7</sup> · PAGESA PËR ASFALTIMIN E RRUGËVE NË FSHATRA TË MALISHEVËS DY PJESË, ME VLERË 43,245€, FATURA ISHTE PRANUAR ME 03.09.2021, NDËRSA ZOTIMI I MJETEVE ISHTE BËRË ME 06.09.2021 DHE PAGESA ISHTE EKZEKUTUAR ME 08.09.2021. · PAGESA PËR ASFALTIMIN E RRUGËVE NË FSHATRA TË MALISHEVËS DY PJESË LOTO 2 CARRALLUKË, TURJAKË DHE BURIM ME VLERË 60,000€, FATURA ISHTE PRANUAR ME 03.08.2021, NDËRSA ZOTIMI I MJETEVE ISHTE BËRË ME 05.08.2021 DHE PAGESA ISHTE EKZEKUTUAR ME 06.08.2021. · PAGESA PËR RIKONSTRUIMIN DHE MBINDËRTIMIN E OBJEKTIT TË SHKOLLËS FILLORE NË FSHATIN MARALI, ME VLERË 22,242€, FATURA ISHTE PRANUAR ME 23.07.2021, NDËRSA ZOTIMI I MJETEVE ISHTE BËRË ME 26.07.2021 DHE PAGESA ISHTE EKZEKUTUAR ME 29.07.2021. · PAGESA PËR ASFALTIMIN E RRUGËVE NË FSHATRA TË MALISHEVËS DY PJESE LOTO 1 DHE LOTO 2 (SITUACIONI I PARË), ME VLERË 48,789€, FATURA ISHTE PRANUAR ME 29.06.2021, NDËRSA ZOTIMI I MJETEVE ISHTE BËRË ME 07.07.2021 DHE PAGESA ISHTE EKZEKUTUAR ME 08.07.2021. · PAGESA PËR ASFALTIMIN E RRUGËVE NË FSHATRA TË MALISHEVËS DY PJESE LOTO 1 DHE LOTO 2 (SITUACIONI I DYTË), ME VLERË 50,308€, FATURA ISHTE PRANUAR ME 20.08.2021, NDËRSA ZOTIMI I MJETEVE ISHTE BËRË ME 26.08.2021 DHE PAGESA ISHTE EKZEKUTUAR ME 30.08.2021. · PAGESA PËR RIPARIMIN E KANALIZIMEVE FEKALE NËPËR FSHATRA TË MALISHEVËS, ME VLERË 19,244€, FATURA ISHTE PRANUAR ME 08.06.2021, NDËRSA ZOTIMI I MJETEVE ISHTE BËRË ME 12.07.2021 DHE PAGESA ISHTE EKZEKUTUAR ME 13.07.2021. · PAGESA PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT TË UJËSJELLËSIT NË FSHATIN ASTRAZUP NË KOMUNËN E MALISHEVËS (SITUACIONI I TRETË), ME VLERË 25,843€, FATURA ISHTE PRANUAR ME 20.05.2021, NDËRSA ZOTIMI I MJETEVE ISHTE BËRË ME 24.05.2021 DHE PAGESA ISHTE EKZEKUTUAR ME 31.05.2021. · PAGESA PËR NDËRTIMIN E NDRIÇIMIT PUBLIK NË FSHATRA TË QYTEZËN E MALISHEVËS, ME VLERË 9,429€, FATURA ISHTE PRANUAR ME 16.02.2021, NDËRSA ZOTIMI I MJETEVE ISHTE BËRË ME 09.03.2021 DHE PAGESA ISHTE EKZEKUTUAR ME 11.03.2021. · PAGESA PËR ASFALTIMIN E RRUGËVE NË FSHATRA TË MALISHEVËS NË DY PJESE LOTO 1, ME VLERË 15,124€, FATURA ISHTE PRANUAR ME 13.12.2021, NDËRSA ZOTIMI I MJETEVE ISHTE BËRË ME 20.12.2021 DHE PAGESA ISHTE EKZEKUTUAR ME 21.12.2021. · PAGESA PËR NDËRTIMIN E INFRASTRUKTURËS PËR GJATË LUMIT MIRUSHA-SEGMENTI NGA URA NË QENDËR DERI TË TRANZITIT, ME VLERË 46,544€, FATURA ISHTE PRANUAR ME 06.10.2021, NDËRSA ZOTIMI I MJETEVE ISHTE BËRË ME 07.10.2021 DHE PAGESA ISHTE EKZEKUTUAR ME 12.10.2021.
- <sup>8</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>9</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>10</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.